




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 29.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **25.09.2020**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik "AGROUNION" SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Furnizim me farë Gruri** " me nr të prokurimit **651-20-4773 -1-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 054 521** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet - kërkesa për ri-shqyrtim e **Operatori Ekonomik "AGROUNION" SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Furnizim me farë Gruri** " me nr të prokurimit **651-20-4773 -1-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 054 521** e dt. **25.09.2020** kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

- 1. AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "AGROUNION" SH.P.K me datës **25.09.2020** ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Furnizim me farë Gruri**" me nr të prokurimit **651-20-4773 -1-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 054 521** Autoriteti Kontraktues me datë **29.09.2020** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1: Ne jemi refuzuar ne kundërshtim te plote me nenin e prokurimit sepse deshmia ne kolonen 2 eshte shume e qarte dhe konkrete, kurse arsyeja per eliminim eshte krejtesisht e ndryshme me kerkesen dhe deshmine e kerkuar. Ne ofertes sone i kemi bashkangjitur kontraten mbi dhenien e lokalit me qira, e cila ka siperfaqe te mjaftueshme, si dhe kjo depo eshte bujqesore qe punon mbi 10 vjet, dhe punon personi me profesion Agronom.

Përgjigje 1: Autoriteti Kontraktues qendron mbrapa vendimin te komisionit per vlersimin dhe ekzaminimit te ofertave i cili me daten 21.09.2020 ka vizituar depot e aplikuesve dhe ka konstatuar se depo e juaja nuk i ploteson kushtet per shkak te hapsires se vogel ose me saktesisht nuk plotesohen as kushtet per deponimin e fares se grurit.

Gjithashtu lokacioni ku eshte depoja nuk disponon me hapsire parkingu per mjetet transportuese te rrethe 1000 fermerve te cilet furnizohen me fare gruri.

Komisioni mer ne konsiderat dhe frekuencen e madhe te automjeteve ku eshte depoja (rruga Gjilan-Prishtin).

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar të gjitha pikat ankimore të Operatorit Ekonomik "**AGROUNION**" **SH.P.K** ku të gjitha pretendimet ankimore bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

Izet Kurteshi
ZPZP